

Legjionaret/ Lazio ofron 2 milione euro per Kacen

nga AlbaniaSoccer

E martë, 03 Dhjetor 2013 00:26



Ergys Kaca dhe Lazio mund te jene se bashku shume shpejt. Mesfushori i PAOK bashke me skuadren greke eshte ne pritje te nje oferte per ne muajin janar nderkohe qe italianet e Lazios i kane bere nje te tille. Mediat italiane kane treguar kete lajm duke theksuar se Lazio eshte e gatshme te paguaj aq sa PAOK deshiron per shqiptarin shtatshkurter. Bisedimet kane nisur prej pak kohesh dhe mund te kulmojne ne fund te muajit dhjetor. Igli Tare eshte i perfshire ne kete histori dhe deshiron shume te marre Kacen tek bardhekaltrit.